



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr.60/01-17845/23
Kaçanik, 24.07.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VII (shtatë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 31 korrik 2023 (e hënë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 31.07.2023 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës ;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2023;
3. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ,ZK Runjevë ;
4. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ,ZK Begracë;
5. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr.60/01-33331/22 ,të datës 29.12.2022 - Për ndryshim plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës 01NR.104/02-19963 ,të datës 02.09.2022 - Për formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-14754/23

Kaçanik, 30.06.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI(gjashtë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 30 qershor 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje me arsye mungoj, Besnik Salihu.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Pranvera Loku-Zharku- DZHET, Sali Malsiu-DSHMS, Hafize Sallahi-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi, Mavije Murseli, pati edhe zyrtar tjerë komunal.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 26 anëtarë, me arsye mungon Besnik Salihu. Kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VI (gjashtë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023, data 30 qershor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Rregullorë për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” në komunën e Kaçanikut;
3. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e komunës së Kaçanikut 2024-2026;
4. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;
5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit, nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2022;
6. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2023;
7. Propozim Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, në Zonat Kadastrale: Doganaj, Koxhaj, Begracë, Kaçanik;
8. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
9. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara, shkollave të komunës;

10. Raporti i KRM “ Pastërtia” SH.A- Njësia Kaçanik, lidhur me menaxhimin e Parkingjeve publike në komunën e Kaçanikut;
11. Kërkesa e MMPHI, për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 104/02-9142/23 i datës 28.04.2023 për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pjesës së PK Nr. 00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin Nerodime;
12. Kërkesa e MMPHI për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 104/02-11896/23 të datës 30.05.2023, për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 26. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e punës në përbërje prej 12 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

Kryesuesi i Kuvendit: Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhjes së V (pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 30.05.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-11910/23.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Kadrije Lika -Troni: E kam një pyetje për drejtorinë e Arsimit, drejtori nuk qenka këtu, besoj kryetari ose nënkryetari kanë ndonjë përgjigje direkte që mos t'i presim përgjigjet vetëm me shkrim. Gjatë kontaktit me qytetarë kam pranuar ankesa për fëmijët me qëndrim tërë ditë në çerdhen e fëmijëve. Gjatë këtij viti, është hera e dytë që prindërit njoftohen me vonesë për shkurtimin e orarit të punës së çerdhës së fëmijëve. Vlen të përmendet një fakt, ku një ditë para festës së Bajramit, në ora 9 të mëngjesit janë njoftuar prindërit me njoftimin e DA, se duhet t'i marrin fëmijët në ora 12:00, se punohet në këtë ditë deri në këtë orë. Kjo ka shkaktuar probleme të prindërit, se është dashur me ndërprerë punën e tyre, ose të angazhojnë dike me i marrë fëmijët nga çerdhja dhe me u kujdesur për ta. Është hera e dytë, se edhe me 7-8 mars, ku çerdhja ka punuar me orar të shkurtuar. Mbi çfarë baze drejtori i DA i merr këto vendime, duke ditur se ligji për festat zyrtare i ka të caktuara festat zyrtare të cilat vlejnë për të gjitha institucionet dhe nuk ka orar të shkurtuar apo gjysmë orar të para festës?

z.Adnan Reka: Në seancën e kaluar unë kisha dy pyetje, për asnjërën nuk mora përgjigje, atëherë, pse duhet të bëjmë pyetje kur nuk marrim as përgjigje?

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori i Arsimit nuk është këtu, ndërkaq drejtori i DUKMM ka qenë jashtë shtetit, besoj se kjo është neglizhenca e tij që nuk ka dhënë përgjigje, besoj se në mbledhjen vijuese drejtori i kthen përgjigjet.

z. Agim Mani: Edhe unë e kam adresuar para dy muajve një pyetje DUKMM lidhur me rrugët urbane dhe rurale, por nuk kam marrë përgjigje.

z. Agim Çaka: Edhe unë i kam bërë një 15 pyetje, përgjigje nuk kam marrë deri tani. Po shihet se është shqetësuese çështja e pyetjeve që ngritën, se nuk epën përgjigje adekuate. Drejtorët duhet me qenë më serioz, me dhënë përgjigje në pyetjet të cilat i ngritëm.

Pyetja: Për problemet dhe intervenimet të cilat bëhen në terren, varësisht prej kompanive, është një problem të lagjia Çaka, është ndërhyrë të ujësjellësi, sigurisht se kur ka ndonjë problem në ujësjellës etj. duhet me ndërhyrë, por çështja është bërë si fenomen, e bënë prishjen me rregulluar diçka, por nuk e sanon gjendjen. Aty është një gropë nja 1m2, e cila është mbushur me ujë, nuk është kthyer në gjendje të mëparshme, e cila paraqet rrezik për fëmijët dhe kalimtarët tjerë të rastit. Disa pyetje të cilat i ngritëm, munden me u dhënë përgjigjet tani për tani, nuk ka nevojë me prituri deri në mbledhjen vijuese, vetëm nëse ka nevojë për ndonjë dokumentacion nga administrata.

z. Betim Shala: Pyetje: A ka caktuar komuna ndonjë koordinator që merret me punët e hekurudhës që janë duke u kryer, se kanalizimet janë duke u derdhur përreth shtëpive, me çka është e pamundur me qëndruar qytetarët aty nga kundërmimet?

z. Naim Beça: 1. U bënë gati 1 vit, që dritat në rrugën “Sali Bajra” nuk rregullohen, ndërkaq ka nxënës që kalojnë atypari nëpër terr. Këtë çështje e kam ngritur edhe para 2-3 seancave, mirëpo nuk është marrë asnjë veprim në rregullimin e tyre.

2. Gjatë muajit që po e lëmë pas, në korzo të qytetit, dritat ditën rrinë ndezur, natën jo.

3. Kush është përgjegjës për mirëmbajtjen e varrezave? Unë kam pyetur shumë njerëz, nuk kam marrë përgjigje. Varrezat janë bërë katastrofë, kjo çështje duhet me qenë e rregulluar se kush duhet me u marrë me këtë punë, Bashkësia Islame apo kush duhet, se bash në hyrje të Kaçanikut gjendja e lokacionit të varrezave është jo e mirë, e jo me prituri me i pastruar dikush në formë vullnetare, e me dalë me njoftuar se i pastruam varrezat.

4. Para 2-3 seancave e kam përmendur çështjen e rrugës “Besnik Begunca” apo siç e quajmë rruga e re. Aty janë krijuar dy gropa, ku si rezultat i tyre ka pasur edhe aksidente. Një sanim shumë i vogël i rrugës është nevojë, sepse ajo rrugë është shumë e qarkullueshme edhe nga fëmijët, veturat duke u larguar nga gropat, po rrezikojnë këmbësorët në atë pjesë. Kërkoj të intervenohet sa me parë në sanimin e gropave të krijuara në atë rrugë.

z. Ekrem Livoreka: Pyetje për drejtorin e DSHPE: A është në dijeni që kamerat e sigurisë nuk funksionojnë. Unë nuk e kam ditur, por e kuptova në mbledhje të Komitetit për Komunitete na njoftoj komandanti i policisë. Kush është përgjegjëse për këtë çështje, kompania kontraktuese apo komuna ?

Kryesuesi i Kuvendit: Fillimisht i inkurajoj drejtorët që të jenë të shpejtë dhe të saktë në përgjigjet e tyre, ndërkaq çështja se a na pëlqen apo jo përgjigja është diçka tjetër. E dyta, nga anëtarët e KK kërkoj të jenë konkret në pyetjet dhe kërkesat që po ngritën, sepse po fillohet me pyetje dhe kërkesa, pastaj po vazhdohet me komentimin e tyre.

2.Propozim Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” në komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe me herët kemi pasur një rregullore për shfrytëzimin e hapësirave të shtëpisë së kulturës, mendimi im është se kjo duhet të jetë ndryshim plotësim i asaj rregulloreje. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ne si grup i LVV do të mbështetim këtë rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj”. Shpresoj që kjo rregullore të hasë në zbatim të plotë.

z. Agim Çaka: E potencuat edhe ju kryesues që kur bëhet një rregullore e re, ajo duhet me u paraqitur si ndryshim plotësim i një rregulloreje. Unë nuk e di si ka qenë rregullorja e vjetër, por kërkoj të dijë cila ka qenë arsyeja me u bërë rregullorja e re, çka është ndryshuar konkretisht prej rregullores së vjetër ?

znj. Hafize Sallahi: Ka qenë një rregullore në pika shumë të shkurta, mirëpo para disa muajve u miratua rregullorja për shfrytëzimin e palestrës sportive dhe e pamë që po funksionon jashtëzakonisht mirë, e kam pa të arsyeshme me hartuar rregulloren me specifikime me konkrete për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës. Rregullorja ka qenë në debat publik me 29.05.2023, i kemi marrë komentet e qytetarëve dhe e kemi plotësuar në mënyrën me të mirë të mundshme me një grup punues prej 5 anëtarëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 23 votë Për, Kundër votë nuk ka, abstenime 3. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

APROVOJ

Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” në komunën e Kaçanikut/ Lënda: 01Nr.09-104/02-14211/23.

3. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e komunës së Kaçanikut 2024-2026;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, fillimisht e hapi diskutimin, pastaj ia kaloi fjalën drejtorit:

z. Agim Mani: Kjo kornizë paraqet një dokument kryesor bazë për draftin e buxhetit 2024-2026. Qarkorja buxhetore 2024 është një udhëzim i parë për përgatitjen e buxhetit komunal, ku përcakton kufijtë fillestar të financimit të komunës për periudhën e caktuar. I keni paraqitur fazat e procesit buxhetor komunal, ju si ekzekutiv i keni caktuar prioritetet në këtë program komunal, ku është cekur në shumë prioritetet, zhvillimi ekonomik, sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në fakt kjo është cekur si prioritet, se nëse analizojmë edhe në formë grafike, kjo del se zhvillimi ekonomik në komunën tonë 2024-2026 në periudhë afatmesëm, në vitin 2025 ka rënie në ndarje të buxhetit duke u bazuar në ndarje të buxhetit. Të Investimet Kapitale-IK të zhvillimi ekonomik 2024, keni ndarë 335,000€, 2025, 100,000€, ka rënie drastike, nuk e di qysh e keni proceduar me prioritet këtë kornizë, ku ka rënie. Në vitin 2026 të IK 150,000€, që në total keni ndarë 234,000€, ku vetëm Zyra e kryetarit i ka 352,000€. Njëjtë keni vepruar edhe të bujqësia, duke ditur se tokat bujqësore zakonisht i keni dhënë për ndërtime, për biznese etj. nuk është ruajtur toka bujqësore, se shpesh herë me vendime të KK toka bujqësore është shndërruar në tokë ndërtimore, ndërkaq bujqësinë e paraqitni si prioritet. Të IK, projektet kapitale të caktuara, po ndalem të zhvillimi ekonomik si prioritet nr. 1 i keni në total 585,000€, mirëpo ne e dimë që keni krijuar edhe kode buxhetore, nuk keni kërkuar konkretisht shembull të zhvillimi ekonomik ndërtimi i rrugës Luboten, ku keni futur vetëm kod buxhetor. Për këtë projekt është dashur të ndahen mjete dhe të kryhet një fazë e punimeve, kur e dimë se në atë rrugë- lokacion zhvillohet biznes i blegtorisë. Nëse dalim e shikojmë gjendjen si zhvillohet biznesi atje, është mjerim, pa infrastrukturë rrugore, ku nuk ka mundësi as me traktor me u ngjitur atje, kurse në anën tjetër thoni se, do të ndihmojmë bujqësinë apo blegtorinë. Në KAB janë futur shumë kode buxhetore që janë të pakuptueshme, si kodi buxhetor për projekte të ndryshme infrastrukturore, ku keni ndarë 945,000€, ndërkaq nuk i keni specifikuar projektet në këtë kod buxhetor. Të ndriçimi publik janë ndarë pak mjete, vetëm 85,000€. Të rregullimi i rrugëve dhe asfaltimi, rruga: Gërlicë-Kaçanik i Vjetër-Stagovë-Runjevë, kjo rrugë ka qenë me prioritet në vitin e kaluar, ka hyrë në disa procedura të prokurimit, pas shkeljeve të kriterëve në prokurim, OSHP e ka kthyer prapa dhe nuk ka mundur me u realizuar ky projekt. Kurse në këtë KAB nuk e keni futur në prioritet vetëm si kod buxhetor, nuk keni ndarë asnjë mjet.

znj. Ardita Rrahmani: Materiali i KAB është bukur voluminoze. Përveç një detyrimi të përmbushur për institucionet buxhetore komunale nga Qarkorja, KAB si e kemi parë, vazhdon t'iu jep prioritet vendbanimeve të afërta me pushtetin e juaj. Pse po e themi këtë: Keni thënë se në tre vitet e ardhme do të bëni transformimin e komunës, ndërkaq kaluan 22 vjet dhe kjo

nuk është bërë. Keni folur për sektorin e bujqësisë në f.6 thoni se 3% merren me bujqësi, ndërkaq në f.14 thoni se janë 4% që merren me bujqësi. Është theksuar potenciali i jashtëzakonshëm për turizëm, a ka rezultate, çka po përfitojmë nga turizmi që po e reklamoni. Vizionin që e keni paraqitur, realiteti është në sh përputhje me vizionin e paraqitur. Krijimin e një mjedisi jetësor standard të qytetarë, qytetarët dita ditës po ikin jashtë vendit. Janë paraqitur 56 projekte të Investimet Kapitale-IK, janë 11 kode të reja, po ritheksoj edhe një herë se iu keni dhënë prioritet atyre projekteve të cilat janë të afërta me pushtetin me KAB 2024-2026, bash kur janë zgjedhjet lokale. “Preni shiritin”, kushtimisht po e themi, dikush iu duartroket, mandej thoni se i kemi bërë për juve. Kryetari qenka këtu, kryetar, nënkryetar, kryesues, të gjithë jemi qytetarë të këtij vendi, krejt duhet me përfituar diçka në të mirën tonë. Kërkoj mos të bëni këso gjerash. Ju mundeni me votuar e me kaluar KAB por edhe buxheti në shtator, por çështja është se ata që nuk po janë me juve, po i vuajnë pasojat edhe po e marrin nga një pasaportë, nga një vizë, ndërkaq kush ka me i gëzuar ato të mira që po i realizoni në IK.

Kryesuesi i Kuvendit: Pasi na u drejtove neve, edhe pse ne nuk bëjmë KAB, po e marrë fjalën. Duhet me qenë konkret se për cilat vendbanime bëhet fjalë, cilat vendbanime kanë mbetur mangut dhe cilat janë favorizuar. E dyta, kur jemi të KAB, nuk është mirë me bërë politikë, por me i adresuar nevojat dhe kërkesat, e jo me na thënë se keni orientuar IK ku i keni votat, se kjo nuk qëndron.

znj. Ardita Rrahmani: Unë e përfaqësoj një subjekt politik, jam e zgjedhur prej qytetarëve të komunës dhe nuk kam kurrfarë obligimi me i sqaruar askujt se kur bëjë politikë, kur jo. Kjo është një KAB publike ku të gjithë qytetarët mundën me pa.

z. Bahri Selimi: Mundësisht potencoj propozimet tua për projekte, është dashur me i dorëzuar projektet, me e provuar se a kalojnë?

znj. Ardita Rrahmani: Nuk kam propozime të mia drejtor, sepse asnjë nuk po kalon. U bënë 23 vjet, janë 56 projekte, 12 janë me kode të reja, i kuptojmë edhe sqarimet e kryetarit pse janë futur kode të reja, por ju po futni kode të reja, pas do muajve përsëri kode të reja, ndërsa projektet pasuese vetëm po barten vit pas viti. Në këtë rast, kod i ri ka qenë, Ndërtimi i SHFMU” Emin Duraku”, projekt ky i cili që sa vite po bartet. Për këtë projekt përsëri janë paraparë 5,000€ e që nuk ka asgjë në këtë drejtim. Si kod i ri është futur, Ndërtimi i aneksit të SHMP, “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, shumë e mirë, iu përgëzoj për këtë projekt, se këtu përfitojnë me tepër të rinjtë dhe siguron që me tepër nxënës të regjistrohen në atë shkollë. Të projekti, Ndërtimi i Çerdhes së fëmijëve në f. Rekë, i keni paraparë 5,000€, edhe këtu nuk ka asgjë, se me këtë shumë as projekt nuk mundesh me bërë. Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU “ Idriz Seferi”, në f. Bob. ka qenë një propozim nga një militantë i juaj që e udhëheqë atë komunitet.

Kryesuesi i Kuvendit: Cili komunitet është favorizuar e cili është anashkaluar?

znj. Ardita Rrahmani: Këto të cilat i përmenda, janë që po kalojnë dhe po iu epët prioritet, është shumë mirë kjo, por mos me i anashkaluar prioritetet tjera vit pas viti.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi: Ardita, faleminderit. Ne si ekzekutiv gjithmonë mundohemi me dhënë një para orientim me qëllimin me të mirë që në debatet publike me juve me i ngritur shqetësimet dhe propozimet e juaja, gjë që nuk po pajtohem se nuk ka propozime të juaja të cilat nuk kanë hyrë në prioritet. Kemi propozime të juaja të këshilltarëve, që sot është këshilltar u.d i drejtorit janë futur propozimet dhe janë miratuar. Jo gjithherë, por janë miratuar. Nuk ishte shumë korrekt. E para, nuk e di cili është elektorati i juaj që e kemi injoruar ? E dyta, po thoni kodet po përsëritën. A e heqim ndërtimin e SHFMU ‘ Emin Duraku” si kod? Ky projekt që kushton 3 milion, nuk mund të realizohet me buxhetin 2 milion për IK, por vazhdimisht e fusim me prioritet me premtimet për donacione. Të SHMP, po thoni se e keni

bërë kodin, buxheti është ndarë në vitin vijues dhe ai projekt kryhet, se me atë buxhet të vogël që kemi, ka me u realizuar. Të shkollat, të gjitha shkollat që kanë mbi 250 nxënës i kemi planifikuar 5 salla të sportit, pavarësisht komunitetit, por janë disa kritere që e përcaktojnë. Duke pasur buxhetin e limituar, i kemi lënë do kode buxhetore, duke shpresuar nga niveli qendror donacione, se projektet madhore nuk i përballon buxheti i komunës. Mos me lënë kodin, thoni pse nuk e keni paraparë, se mund të vjen mundësia. Të çerdhja, kemi premtim zyrtarisht nga qeveria 2 çerdhe, në Rekë dhe Kaçanik të Vjetër, na kanë kërkuar me i futur në kode dhe me i dërguar parcelat, na kanë thënë këtë vit ose vitin vijues kanë me u ndërtuar çerdhet. Pa kode është vështirë me realizuar projekt, ndërkaq projektet që përsëriten që 5-6 vjet, por moralisht nuk me lejon me u hequr. Projekti i rrugës: Kaçanik- Llanishtë-Viti, ka kohë që është miratuar, është nënshkruar një memorandum, nuk zbatohet ende. E kemi rrugën: Gërlaçë, është që shumë kohë, por nuk po mundem me hequr, por se paku të jetë si kod, me shpresë të reflektimit të qeverisë, se me buxhetin tonë nuk mund të realizohen, por se paku të mbeten si kod, duke shpresuar si të projekti i rrugës Stagovë, që dështoj, kod ka pasur, mjetet kanë qenë në granti i përformancës, por nuk e kemi përfutur atë grant, për shkak të opinionit të auditorit. Edhe të projekt tjera, çështja ka qenë se kemi shpresuar në donacione nga ministria e linjës që kemi aplikuar në projekte. Nuk qëndron ajo që se projektet po orientohen ku janë militantët e partisë në pushtet. Ju në debate publike me qytetarë mundeni me na akuzuar, me propozuar projekte me prioritet, me na treguar se cilin projekt me hequr, se nuk është me prioritet dhe me futur projekte tjera që i mendoni se janë me prioritet. Nëse ne e refuzojmë pa ndonjë arsye projektin që e propozoni, mundeni me na akuzuar, dhe e keni një arsye nëse votoni kundër prioritetëve, për shkak se nuk kanë hyrë ato që i keni propozuar ju. Ju po mungoni në debate publike, na po ju japim prioritet projekteve ashtu qysh po dimë ne, ndërkaq nëse ju merrni pjesë në debate publike, jepni propozime, dhe na ndihmoni shumë. Në fund qytetari na vlerëson se a kemi vepruar mirë apo keq.

z. Adnan Reka: A është kriter numri i nxënësve të shkollës 200 nxënës me përfutur sallë të edukatës fizike, se ne dimë shkolla nën këtë numër që kanë përfutur sallë? Shkolla e f. Bob nuk e ka këtë numër.

Kryetari i Komunës: Ky është një kriter i përcaktuar para 4 viteve në bazë të kësaj formule, ku në çdo shkollë me numër mbi 250 nxënës kemi planifikuar me ndërtuar shkollë. Mund t'na ikë ndonjë detal, shkolla 'Idriz Seferi' e ka këtë numër, shkolla amë me paralelet fizike.

z. Selajdin Troni: F. Kovaçec ka shumë votues atje të PDK, mirëpo kriteri i numrit të nxënësve na ka penguar me u ndarë shkolla. Kriteri na ka ardhur nga ministria, jo nga komuna. Shkolla e ka hapësirën e ka oborrin, i ka krejt mundësitë, por çështja është se në bazë të kriterit të ministrisë, nuk mundet me u ndarë pa i pasur 250 nxënës. Na kanë penalizuar edhe të pjesa e ndërtimit të palestrës, se kriteret e përcaktuara po pengojnë, se nuk është çështja që projektet shkojnë kah e ka elektoratin partia në pushtet. Nuk është mirë me zhvilluar debatin në atë formë, por duke biseduar, sqarohet kriteri që e pengon shkollën mos me pasur sallë.

z. Adnan Reka: Faleminderit për tentativën për me sqaruar Selajdin. I kuptoj kriteret, ato kritere nuk janë të sakta që iu kanë thënë. E dyta, nuk bëhet fjalë për ndarje të shkollës, por për ndërtimin e sallës së edukatës fizike, gjë që fëmijët e Kovaçecit nuk munden me shfrytëzuar sallën në shkollën e Bobit. Nxënës në shkollën e Bobit nuk janë 250, unë kam dëshirë me qenë, por nuk janë, unë i kam statistikave të sakta qysh i keni edhe ju.

Kryesuesi i Kuvendit: Secili vendim, projekt, i referohet statistikave zyrtare. Ne e dimë se shkolla e Bobit dhe e Kovaçecit përderisa nuk janë ndarë, statistikave numërohen si shkolla "Idriz Seferi" në f. Bob, ndërsa kur të ndahen, atëherë statistikave janë tjera, sa e di unë vetëm kjo shkollë është jo e ndarë, shpresoj të ndahet. A munden me shfrytëzuar apo jo sallën, sot për sot është kështu dhe duhet trajtuar kështu si është.

z. Selajdin Troni: Ne kemi kërkuar nga kryetari me u ndarë shkolla, por kriteri ka qenë prej ministrie që pa i pasur 250 nxënës nuk mundet me u ndarë shkolla. Ndoshta mund të ndryshojnë kriteret, se po e shohim se numri i nxënësve është në rënie e sipër. Të pjesa e kriterit të komunës që e ka bërë drejtori, nëse kryhen shumica e palestrave, ka me i ardhur rendi edhe shkollës së Kovaçecit edhe shkollave tjera.

Kryesuesi i Kuvendit: Mos e merrni këtë që drejtori ka vendosur kriter, drejtori është nisur nga një parimi që me u pajisur me salla sportive fillimisht shkollat që janë me të mëdha.

z. Adnan Reka: Selajdin, ka shkolla në komunën e Kaçanikut që janë me të vogla me numër të nxënësve sesa shkolla e Kovaçecit, por që kanë sallë të edukatës fizike.

z. Selajdin Troni: Ka pasur shkolla të ndara por me numër mbi 300 nxënës, por tani ka ra numri i nxënësve. Tani, nuk mundesh me ua marrë sallën shkollës pse janë ndarë shkollat dhe iu ka ra numri i nxënësve. Shkolla e Ivajës ka pasur mbi 300 nxënës, por tani ka ra numri i nxënësve. Shkolla e Kovaçecit ka mbetur me atë kriter, nëse rritet numri i nxënësve, ka me u ndarë kjo shkollë dhe ka me pasur palestrën.

z. Adnan Reka: Politikat integruese të komunës për lokalitete, komuna duhet me i bërë paraprakisht para se me ikur popullata, se stimulon komunitetin për me qëndruar aty, në të kundërtën ka me pasur çdo ditë rënie, për faktin se, pse me ndenjur në Kovaçec, kur kushtet janë me të mira në Kaçanik.

Kryesuesi i Kuvendit: Sipas teje Adnan, pse nuk pavarësohet shkolla në Kovaçec, pasi ka shumë kërkesa dhe shumë iniciativa? Ju po doni me nxitur një debat politik për me reflektuar ne.

z. Adnan Reka: Meqë po me drejtoheni, po ju jap përgjigjen: Për arsye e ju, atë bastionin e vogël po doni me mbajtur ende.

Kryesuesi i Kuvendit: Këto janë supozime të juaja, se ka shumë shkresa zyrtare që komuna ka kërkuar me u ndarë shkolla. Ka shkresa zyrtare që janë kthyer që shkolla nuk mundet me u ndarë.

z. Adnan Reka: Ka shumë kërkesa zyrtare që komuna i ka bërë veç sa për t'i bërë. Edhe unë kam bërë shumë kërkesa këtu, por vullneti nuk është me u realizuar. Varet sa jeni pro aktiv atje, se që 20 vjet nuk janë realizuar kërkesa të tilla.

Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Dua të ndërlidhem të fusha e arsimit, të kriteret të cilat u theksuan, nuk është kriter institucional që e ka vendosur komuna, por çështja është e premtimeve, ashtu si u premtua çerdhja e fëmijëve në krejt Kosovën në nivel qendror, ku janë premtuar 2 çerdhe të fëmijëve. Të çështja e fushave sportive, jemi duke i pajisur shkollat me fusha sportive, siç është ajo në Begracë që ka përfunduar, ajo në Elezaj para përfundimit, Biçec, Dubravë, duke marrë kriter numrin e nxënësve, që për tre vite, që mos me migruar jashtë shtetit. Të shkolla "Idriz Seferi" shkolla e Kovaçecit ka bërë kërkesë për ndarje, por problem paraqet numri i nxënësve. Dua të ngriti edhe një çështje, e di se Adnani ka me reaguuar që po potencohet se Bobi është bastion i PDK, dhe salla sportive ndërtohet në këtë shkollë. Doganaj është bastion i PDK atëherë për atë ju nuk po e vazhdoni kontratën që është në vitin 2019, e që e dini fort mirë se është bërë marrëveshje që çdo qeveri që vjen, e ka obligim me përfunduar atë shkollë, ndërkaq nuk ka asnjë lëvizje në këtë drejtim. E dini mirë se shkolla e vjetër ka insekte që e bëjnë dezinfektimin në çdo kohë. Kemi dërguar email nga Kryetari i komunës, DA dhe Këshilli i prindërve, por nuk na është dhënë asnjë përgjigje. Kur një çështje e ngrit në nivel lokal, mundeni me ngritur edhe në nivel qendror me ndihmuar çështjen e shkollës në Doganaj. Të shpërndarja e buxhetit që u potencua nga parafolësit, ajo që prekë me së tepërmi zonën urbane është çështja e nënkallimit për këmbësor. Ne kemi pritur nga qeveria nga INFRAKOS, por nuk

ka pasur vullnet me na financiar dhe jemi detyruar për shkak të nevojës imediate – kalimit të nxënësve, me ndarë shumën 240,000€ me u ndërtuar nënkalimi hekurudhor. E kemi urën mbi lumin Nerodime që është në zonën urbane, hyrja të Gjumnazi, Sheshi i qytetit, dy shëtitore, shkallët të Guri i shpum dhe shumë projekte tjera që jemi munduar në mënyrën me të mirë të mundshme me i përfshirë të gjitha lokalitetet. Ju ftojme të kontribuoni në debate publike, t'i adresoni kërkesat, pastaj ne mundohemi me i futur ne buxhet me këto mjete që i kemi, me arsyetimin më të mirë. Nëse nisemi nga bastionet, Doganaj, Dubravë, Kaçanik i Vjetër, janë tre bastione, por çështja është se nuk është ndarë ndonjë shumë e madhe buxhetore në investime të projekteve të këtyre tre lokaliteteve.

z. Adnan Reka: Me të drejtë e ngrite çështjen e shkollës në Kovaçec, por shkolla "Idriz Seferi" a është në Kovaçec apo jo, nëse po atëherë, pse çdo projekt shkon për shkollën e Bobit, e asnjëherë për f. Kovaçec? Sa i përket çështjeve që e potencove me i ngritur në nivel qendror, unë mundem me i ngitur, por ju duhet me i ngritur në formë institucionale. Se ju e keni mandatin dhe çështjen ngritën në vijë institucionale e jo në vijë private. Ato që i përmendi nënkryetari, inestet në shkollën e Doganaj, në shkollën e Kovaçecit nga lagështia kanë mbërri në gjysmë të shkollës, projekti ka qenë me investime komunale. I dinë anëtarët e KK, Selajdin Troni dhe Kadrije Lika-Troni që i kanë pasur fëmijët në atë shkollë, ndërkaq nuk po flas për aferat korruptive për atë shkollë. Që 23 vjet, a i keni ngritur çështjet në vijë institucionale apo nuk i keni ngritur? Nëse i keni ngritur dhe nuk kanë kaluar, atëherë ju duhet me u marrë me vetveten, se nga përvojat e këqija që kanë pasur me juve, nuk kanë besim me ua realizuar projektet.

Nënkryetari i Komunës: E para, Bobi zyrtarisht i ka 164, Elezaj e Bajnica 332, Begraça 292. E dyta, projektet kanë shkuar në vijë zyrtare nga Zyra e kryetarit, nga DA, projektet kanë shkuar në secilën ministri të linjës. Nuk është puna me financiar të gjitha projektet, por se paku me i vazhduar ato projekte që janë me marrëveshje. Kryetari iu ka thënë publikisht edhe juve, kurdo që është një projekt në të mirë të qytetarëve, me juve jam. Të gjitha projektet i ka edhe deputeti i kuvendit të Kosovës nga Kaçaniku.

znj. Fitore Vishi: Draft Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës sonë për vitet 2024-2026 në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore, synon arritjen e të gjitha objektivave për periudhën afatmesme. Kjo draft kornizë, mbështetet në hyrjet reale buxhetore të komunës dhe prioritetet investive për kornizën afatmesme dhe planifikimet zhvillimore në zonën urbane dhe zonën rurale të komunës së Kaçanikut. Komuna jonë i plotëson të gjitha kushtet për një zhvillim më të hovshëm ekonomik dhe zhvillimor, duke i pas parasysh resurset e shumta natyrore që kjo komunë disponon dhe që në këtë Draft Kornizë për vitet 2024-2026 janë planifikuar në detaje. Diskutimet lidhur me këtë material mund të zhvillohen, me qëllim pasurimin eventual të tij, por në emër grupit parlamentarë të PDK-së, propozoj që ky dokument të votohet edhe nga grupet parlamentare të opozitës parlamentare.

z. Bashkim Luma: Drejtori i financave na tha: propozoni prioritetet. Terreni sportiv në f. Glloboçicë është propozuar, është kërkesë shumë vjeçare, ndërkaq kryetari sot na tha se nuk mund të realizohet pa i pasur 250 nxënës. Ky projekt nuk mend të realizohet, sepse ai fshat i ka 180 nxënës, ndërkaq nuk është kriter i drejtë ky që drejtori i arsimit e ka marrë për bazë.

Kryetari i Komunës: Bashkim, me paske keqkuptuar. Unë thashë fillimisht e kemi marrë si kriter numrin e nxënësve 250, ndërkaq nuk kam thënë se janë të përjashtuar shkollat edhe me 100 apo 50 nxënës. Në Glloboçicë në vitin vijues do të aprovohet një kërkesë e komunitetit për një fushë sporti, në terren të jashtëm, që ka vlerë bukur të mirë, do të realizohet kjo para sallës së sportit, ndërkaq nuk është përjashtuar as salla e sportit. Mund të vjen mundësia për shkak të largësisë me i kaluar disa shkolla tjera.

z. Bashkim Luma: Terrenet sportive në Kornizën Afatmesme Buxhetore e Komunës tonë për vitet 2024-2026 nuk ekziston si projekt.

Kryetari i Komunës: Terrenet sportive Bashkim i keni në vitin vijues. Gjithmonë buxheti kur të bëhet, bëhet për vitet vijuese në bazë të kërkesave dhe ndryshohen varësisht prej prioriteteve.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kryetar, desha të ndërlihem edhe unë me pyetjen: Ne e dimë që shkolla “Idriz Seferi” është në Bob, paralelet e shkollës janë në Kovaçec dhe Gajre, atëherë pse kur ka projekte të tilla, nuk merret parasysh që projekti i sallave paralelisht të shkoj edhe të paralelet e kësaj shkolle, se edhe nxënësi i Kovaçecit e përfaqëson shkollën “Idriz Seferi”, pse atëherë nuk realizohen projektet vetëm si shkollë e “Idriz Seferi”, por po bëni ndarje.

Kryetari i Komunës: Sepse është dashur me ia nisur së pari nga shkollat tjera, si në Kaçanik të Vjetër, që nuk e kemi bërë, për atë e kemi bërë njëherë të një shkollë, pastaj i vjen rendi shkollës tjetër, ku si pas teje, duhet me bërë sallën së pari në shkollën e Gajres, këtë nuk e kupton logjika. Ne i kemi dhënë prioritet shkollës “Idriz Seferi”, kjo shkollë e ka një drejtori, dhe ajo na përcakton, a me ndërtuar shkollën në Gajre apo Kovaçec, ai e përzgjedhë. Sikurse unë që jam kryetar këtu, dhe me rrethin dhe komunitetet, vendosim cilave nga projektet me iu dhënë prioritet. Në i kemi përcaktuar shkollat se ku me u ndërtua sallat e edukatës fizike, shembull konkret e marrim shkollën “Kadri Zeka” në Dubravë, ne i kemi dhënë prioritet, ndërkaq drejtorja e shkollës vendosë që salla të ndërtohet në Vataj. Ne e kemi përcaktuar shkollën e Bobit me ndërtuar salla e edukatës fizike, shkolla e Kovaçecit është shkollë e re dhe mund t’i vjen radha edhe për sallë të edukatës fizike, ndërkaq me duket jo e arsyeshme si propozim për ndërtimin e sallave fillimisht në Kovaçec dhe Gajre.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kryetar, ne kur e marrim fjalën, nuk ka nevojë me na treguar se çfarë pyetjesh apo propozimesh bëjmë. Unë e bëj pyetjen, ndërkaq ju me përgjigjeni. Pyetja ishte shumë konkrete. Nxënësi i shkollës së Kovaçecit dhe i Gajres, janë nxënës të shkollës “Idriz Seferi”. Këtu po bëhet diskriminim në mes të nxënësve të kësaj shkolle të Bobit, Kovaçecit dhe Gajres. Pyetja ime ishte: Pse nuk munden me u bërë sallat përnjëherë në këto shkolla? Ju duhet me ma dhënë sqarimin. A është pyetje logjike apo jo, ajo është logjika ime.

Kryetari i Komunës: Mua nuk mu duket pyetje logjike, pyetja e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit: Përfundoni këto çështje me gjuhë të urrejtjes, sepse për dike mundet me qenë pyetja logjike, por për dikën jo. Krejt debati po orientohet në salla të edukatës fizike, ndërkaq ka edhe shumë problematika tjera. A është diskriminim i nxënësve, është një përcaktim, a është i drejtë apo jo, zakonisht duhet të trajtohen njësoj në aspekte tjera, që janë të realizueshme për tri shkollat. Kur jepet mundësia për një projekt të shkollës, duhet të realizojmë se nuk kemi mundësi për tri shkollat, e jo mbi këtë bazë të lëmë krejt projektin.

z. Naim Beça: A ka sallë të edukatës fizike shkolla “Emin Duraku”?

Kryesuesi i Kuvendit: Shkolla “Emin Duraku” duhet me u ndërtuar komplet e re, me sallë e me krejt, se ajo shkollë nuk ka kushte për shkollë. Fokusoni debatin edhe në prioritetet tjera të KAB.

z. Agim Çaka: Debati i qetë, me përgjigje të sakta, me pas durim me dëgjuar tjetrin edhe kur bëjmë ndonjë pyetje që nuk kemi diçka të qartë, i kontribuon procesit. Të shpërndarja e buxhetit, unë jam të bëhet në formë proporcionale në projektet me prioritet. Kjo nënkupton që një komunitet që i ka të gjitha projektet e realizuara, por nuk e ka ujësjellësin, duhet me ia realizuar projektin e ujësjellësit, ndërkaq një komuniteti që i ka të gjitha dhe me ia realizuar dritat, e komuniteti tjetër nuk ka ujësjellës, kjo është e padrejtë. Kur të bëhet planifikimi i buxhetit, duhet me pasur parasysh çështjen e shpërndarjes. Unë nuk po foli për Bobin se u fol mjaft, ndërkaq po foli për Doganajt. Ky komunitet ka problem që sa kohë me ujin e pijes, problem ky që duhet me pasur parasysh komuna, sepse nuk mund të kënaqemi nëse në një

komunitet janë të gjitha, ndërsa komuniteti tjetër, ka mungesë të projektit esencial –ujin e pijes. Është e drejtë e opozitës që sipas parashikimeve të tyre, kërkesave me qytetarë, me bërë pyetje. Unë mendoj se një prej prioriteteve në raport me fshatin, prioritet është qyteti, duhet me investuar me shumë. Nënkryetari i përmendi disa prioritete në qytet, por pak shumë kanë fjalë të mira për prioritetet që janë bërë në Kaçanik dhe për rregullin e krijuar, në bazë të kontakteve, vizitorëve edhe vet si e shohim. Një problem e përmendim që 5 muaj, e nuk është rregulluar ende, pastaj Kalaja, Bulevardi është degraduar, duhet me pas një rregull për pikat ambulatore me pas projekt me qenë të ngjashme dhe çka ka me punuar aty, me pas një strategji. Çështja e parkingjeve janë në gjendje jo të mirë, me ardhur një mysafir nuk ka parking dhe janë urgjente me u realizuar. Ne e kemi pa një farë publikimi që është bërë që komuna e jonë është zero për IK, a është e vërtetë apo jo nuk e di. I kisha bërë pyetje ku kemi arritur me IK në 3 mujorin e parë dhe 6 mujorin e dytë, sepse sipas asaj informate po del se ne nuk jemi duke punuar asgjë. Kudo që realizohet ndonjë projekt, është mirë, por duhet me shkuar me prioritet në bazë të parimeve që i potencova.

z. Naim Beça: Komuna e Kaçanikut e ka një problem shumë të madh, çështjen e SHFMU "Emin Duraku" që ka mbi 1000 nxënës, ndërkaq secili fol për komunitetin e vet, flasin për shkollat e vogla, nuk flasim për këtë projekt, që jemi në qendër të vëmendjes në krejt Kosovën. Shkolla është duke u prishur dita ditës, drejtori nuk është këtu, është dashur me qenë. Pyetja është: A ka ndonjë plan B për këtë shkollë. Tualetet janë në gjendje të keqe. Unë nuk dua asnjë projekt, pos këtij projekti, se ky projekt nuk bënë me u anashkaluar. Që tre muaj ditë kemi kërkesë për rregullimin e asfaltit në një pjesë të rrugës ku janë krijuar gropa, askush nuk është marrë me këtë çështje. Nuk jam kundër asnjë shkolle, por çështja është së SHFMU "Emin Duraku" është e ndërtuar që 70 vjet, ndërkaq dihet gjendja e saj. Flasim këtu për çështje dytësore e tretësore nëpër fshatra të ndryshme, ndërsa nuk flasim për çështjen parësore të projektit të kësaj shkolle, kjo nuk është në rregull.

z. Bashkim Krasniqi: Për çdo projekt që ndërtohet diku, qoftë sallë apo diçka tjetër, ne duhet me u gëzuar se po ndërtohet diçka, pavarësisht komunitetit ku ndërtohet në Bob apo Kovaqec etj. Unë po e shoh këtu se ka debate pse ky projekt po ndërtohet në Bob ? Sot ndërtohet në Bob, nesër i vjen rendi edhe në Kovaqec. Po flitet për diçka që po ndërtohet dhe krejt debati po orientohet këtu. Kudo që ndërtohet diçka, unë nuk jam kundër, qoftë në Stagovë apo në Kaçanik të Vjetër. Prioritete janë përcaktuar, ndërkaq nëse e shikojmë mendimin e secilit person, secili ka nga një prioritet. Debati për KAB është mbajtur, ju keni pasur mundësi me marrë pjesë dhe me i paraqitur kërkesat për prioritete, por ju nuk keni marrë pjesë. Askush nuk e din se çka mendoni ju, nëse ju nuk e thoni. Është mirë me u ndërtua shkolla, me pasur investime sa me tepër në komunën tonë, por diçka që nuk po me pëlqen është se po ndërtohet. Sa herë akuzoni se nuk po ndërtohet, nuk po ka investime, ndërkaq tani po akuzoni, pse po ndërtohet.

z. Betim Shala: Të hyrja e qytetit është një park, i cili park duhet me u riparuar komplet, se ky projekt ia ndryshon krejt pamjen qytetit. Unë nuk e di pse ky projekt nuk ka hyrë në prioritet. Është mirë ky projekt me hyrë në prioritet, se janë edhe dy shtatore aty, hyrja e qytetit. Janë do hapësira publike që janë paraparë nga 20-30 mijë euro, ky projekt kushton diku nga 70,000€ dhe është mirë të hynë në prioritete, se është parësore për hapësirat publike.

z. Naim Beça: Bashkim, mos mendo që unë nuk gëzohem kur ndërtohet një shkollë, se në qoftë se gëzohem për diçka, gëzohem për kushtet e nxënësve në shkolla. Në po flasim për mos punë, se po të ishin ndërtuar shkollat në Kaçanik etj. ne nuk kishim diskutuar, por që 20 vjet shkolla nuk po ndërtohet.

z. Bashkim Krasniqi: Ne gëzohemi Naim për çdo projekt kudo që realizohet, por janë disa arsye që i tha kryetari, por ju nuk po dëgjoni arsyet. Ju nëse i dini përgjigjet, atëherë pse po bëni pyetje.

z. Betim Shala: Të rruga “Skënderbeu” tani që është bërë hekurudha, një pjesë e parkingjeve nuk mundet me u realizuar për shkak të hekurudhës. Kërkoj të shqyrtoni mundësitë për një parking në atë pjesë – me nda mjete për shpronësim të pronës, ose rruga të bëhet një kahe, se aty mbetet vetëm 1.20m gjerësia.

z. Agim Çaka: Kur po thuhet se po punohet, çështja është të punohet si duhet. Në rrugën “Sali Bajra”, është mundësi e mirë me u rregulluar me kanalizim, ndriçim publik, me u hequr telat e stubat, por nuk është bërë asgjë. Ky është dyshimi se, ata që po merren me projekte nuk po e bëjnë planin dhe punën si duhet. Kërkesa ime për ekzekutivin e komunës në përgjithësi është, ajo punë që bëhet, të bëhet si duhet, e jo pastaj pasi të realizohen pas 2 vjetëve ne me diskutuar për defektet, se në letër ne po i qesim mirë çështjet, por defektet po dalin me vonë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 14 votë Për, Kundër ishin 10 (7 nga LVV, 3 nga LDK), Abstenuan 2 (Raif Kasa dhe Agim Çaka). Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) e komunës së Kaçanikut 2024-2026. KABK lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarë/ Lënda: 01Nr. 400/01-14264/23.

4.Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Për të qenë i saktë, që nga viti 2017, nga koha kur jam anëtarë i Kuvendit Komunal, Komuna e Kaçanikut kurrë nuk ka pas Raport të Auditimit për pasqyrat financiare më të mirë se këtë vit, ama bash asnjë vit. Sepse, edhe vetë po ta kishit shkruar këtë raport nuk besoj që do të kishit nxjerrë një Opinion të tillë të Pamodifikuar, së paku do të kishit ‘Theksuar ndonjë çështje’ nuk e besoj që për **gjetje** të njëjta nga vitet e kaluara të mos e theksonit bile ndonjë çështje. Ama ju s’keni çfarë bëni, sepse Auditori i Shtetit e ka përpilua raportin. Pra, është çudi e madhe se si auditori i njëjtë nga vitit i kaluar, Florim Beqiri të jetë dy vite radhazi udhëheqës i ekipit të auditimit në Kaçanik, dhe për **gjetje** të njëjta të jap Opinione shumë të ndryshme. Për gjetjet e njëjta siç ishin vitin e kaluar, Mungesa e Projektit Ekzistues dhe Regjistrimet e gabuara të pasurive kapitale, për të cilat ekzekutivi nuk u pajtua, auditori dha Opinion të Kualifikuar. Ndërsa këtë vit për gjetjet e njëjta, bile edhe të përsëritura, siç janë: B1 Komuna kishte lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projektin ekzekutues.

B2 Vetura ne vlere 24,850 E, ishte regjistruar ne klasën e gabuar.(ne vend te IK, MSH). Ekzekutivi u pajtua, ndërsa auditori dha Opinion të pamodifikuar dhe nuk theksoi asnjë çështje. Më tej, te Ndërtesa për Banim Social, Kryetari kishte lejuar që paraprakisht Operatorit Ekonomik ti jepen 40, 676 euro, edhe pse një gjë e tillë nuk ishte parapare me kontrate.

Pra, të gjitha këto gabime, keq klasifikime apo mashtrime bëhen për të paraqitur kinse një realizim të mirë të buxhetit, që këtë vit e kishim te realizuar afro 90%, por, ja qe kjo paska qene një mashtrim sepse ekzekutivi i paska dhënë paratë e buxhetit komunal para kohe, pa arsye te mjaftueshme vetëm sa për ta harxhuar disi buxhetin. Besoj se ju kujtohet viti i kaluar, kur ne Kuvend u bë shumë zhurmë rreth raportit të auditimit, nuk pajtoheshin asses me raportin, bile auditori u quajt i padrejtë dhe i njëanshëm atëherë. Tani pyetja ime është, auditori këtë vit, a ishte i njëanshëm, a ishte i paanshëm, pra na thoni, a ishte i njëanshëm, a ishte i paanshëm auditori, Florim Beqiri.

z. Agim Mani: Ky raport në përmbajtje cekët opinionin e auditorit, gjetjet dhe rekomandimet dhe informacionet për planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe progresi. Edhe pse auditori e ka nxjerrë një opinion të pamodifikuar në pasqyrat vjetore financiare deri me 31 dhjetor 2022, në anën tjetër auditori ka gjetje dhe çështje të shumta për rekomandime. Nga 10 rekomandime

8 janë të këtij viti, ndërkaq 2 janë të përsëritura. Disa çështje të rëndësishme i ceku Adnani, po fokusohemi në çështje tjera, të B1, mungesë e projekteve ekzistuese. Në këto raste kemi vërejtur që komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit, pa hartuar projektet ekzekutuese. Rasti ishte të kontratat, rasti i ndërtimit të sallës së edukatës fizike në SHFMU “Nazmi Osmani” në vlerë 315,916€ nga vjen edhe drejtori i DSHPE, ndërkaq tjetra është, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane dhe rurale në vlerë 275,843€. Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e komunës për me hartuar projekte ekzistuese. Këtu bëhet fjalë për një shumë 600,000€, që i ka dhënë komuna pa projekte. Të rrugët urbane dhe rurale, unë e kam bërë një pyetje në DUKMM se është vazhduar me mendësinë e njëjtë edhe në këtë vit. Nuk me është dhënë përgjigje se cilat janë rrugët lokale në vitin 2023 që kanë me u shtruar, të ceket vetëm segmenti i rrugës, se përsëri i keni futur në një kod buxhetor rrugët lokale dhe paramasa. Si keni me i zbatuar këto rekomandime të cilat janë në vazhdimësi e sipër.

z. Rustem Zenuni: Sa i përket raportit të auditorit, ne jemi shumë të kënaqur, që së bashku me ekzekutivin kemi arritur me bërë një punë tepër të mirë, e që del vlerësim i auditorit. Këto ankesat që i bëjnë kolegët, ardhja këtu duhet me thënë diçka, mirëpo mos të nënvlerësohet ajo punë e madhe e zyrtarëve, ekzekutivit dhe e jona që e falënderoj drejtorin e financave i cili në seancën e kaluar na ka falënderuar për angazhimin për vendimin që kemi marrë për bartje të mjeteve, që ato mjete të shfrytëzohen në mënyrën me të mirë të mundshme. Sa i përket raportit të auditorit të kaluar, unë e mbaj mend mirë këtu në KK edhe diskutimin e kryetarit, vlerësimi nuk ka qenë ashtu Adnan, rekomandimet i ka dhënë auditori, ekzekutivi i ka zbatuar ato rekomandime në bazë të planit të veprimit, mirëpo prapë në pika të njëjta auditori ka dalë në kundërshtim me vetveten. Sa i përket gjetjeve që i potencoj kolegu, mund të ketë gabime nganjëherë, por nuk mund të bien poshtë tërë ai mund që është bërë.

z. Agim Mani: Desha me u ndërlidhë me kolegun që tha se duhet me fol diçka, ne nuk po flasim çka ne mendojmë, por çka ka dhënë auditori. Nëse auditori duhet me thënë diçka, e ka thënë të vërtetën, se afër 600,000€ kanë dalë procedura tenderuese pa projekte. Këtë e ka thënë auditori e jo unë.

z. Adnan Reka: Ne po flasim drejtë dhe saktë, duke u bazuar në dokumentet e auditorit. Ne po themi i njëjti auditor vitin e kaluar Florim Beqiri, për të njëjtat gjetje, ka dy opinione të ndryshme, në vitin e kaluar ka pasur opinion të kualifikuar, ndërsa këtë vit për të njëjtat gjetje, ka dhënë opinion të pamodifikuar, pa asnjë çështje të theksuar. Është e pamundur kjo Rustem kjo. Buxheti është realizuar në saje të paradhënieve fare pa kontrata para kohe, ku janë shpenzuar 600,000€ dhe të tjerat që u potencuan këtu. Mjetet të cilat janë dhënë, ka rezultuar se buxheti është shpenzuar 90%, a në fakt auditori ka thënë se ju nuk keni pasur dokumente, i keni dhënë mjetet pa pasur projektet. I citoj thëniet e auditorit: “Komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projekte ekzistuese”. Pa pasur projekt, e ka lëshuar dokumentacionin e tenderit, kjo është e ndaluar Rustem.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket raportit të auditorit, po ndërlidhem të raporti i vitit të kaluar, është i njëjti auditor që ka dhënë Na pëlqej apo jo, raporti është i një organi të pavarur, i cili të jep mundësi me i komentuar të gjeturat dhe në fund jepet raporti përfundimtar. Raporti përfundimtar na pëlqej apo jo, është raport përfundimtar. Për një raport jo të mirë, ne i kemi vuajtur pasojat, por me na penguar sivjet raporti i mirë, nuk bënë se ky raport na bënë me përfituar diçka komuna. Ky raport është një nga raportet me të mira deri tani dhe duhet vlerësua, është bërë nga një organ i pavarur, a është real apo jo, ne mundemi mos me u pajtuar, raporti duhet të zbatohet ashtu siç është, raport të auditorit pa të gjetura nuk ka, jemi ndër komunat që e kemi raportin me të mirë të auditorit. A janë ato të gjetura të mëdha që këtu të diskutojmë, nuk besoj, se një e gjetur e madhe është vepër penale dhe ngritët aktakuzë ndaj zyrtarëve përgjegjës. Krejt po pajtohem se raporti është i mirë, ndërkaq duhet insistojmë edhe për raport edhe me të mirë, sidoqoftë me pasojat që kemi vuajtur me raportin paraprak, në këtë vit është bërë punë me e mirë dhe raporti është me i kënaqshëm. Raporti është i pamodifikuar dhe duhet

trajtohet ashtu si na vjen nga Zyra e auditorit dhe të punojmë për raporte ende me të mira, sepse çdo punë e jona e mirë përfitojmë në grantin e performancës dhe përfitime tjera.

z. Adnan Reka: Ne po pajtohemi që raporti është i mirë, ne po e ngritëm si shqetësim sesi mundën dy raporte me të gjeturat e njëjta, njëri të jetë i kualifikuar, ndërkaq tjetri të jetë i pamodifikuar dhe pa theksim të çështjes. Në vitin e kaluar nuk jemi pajtuar me të gjeturat në raport, dhe ju këtu në KK e keni quajtur të njëanshëm auditorin, u ndërrua qeveria etj. Unë pyeta për raportin e këtij viti: A është auditori i njëanshëm se është i njëjti auditor? Nëse vjet auditori ka qenë i njëanshëm, si mundet sivjet me qenë i paanshëm.

Kryetari i Komunës: Unë mendoj që secili duhet me iu gëzuar opinionit të auditorit kur është dalë i mirë dhe për këtë jemi kontribues të gjithë, ku me shqetësimet dhe kritikën që i keni bërë, kemi arritur deri të ky rezultat dhe duhet t'i gëzohemi se bashku me qytetarët, sepse kemi marrë një opinion siç e tha edhe kryesuesi, është prej me të mirëve nga mandati i kësaj qeverisje. Në fakt, gjetjet gjithmonë janë evidente, por auditori nga të gjeturat ka vlerësua se nuk ka të gjetur me theksim të çështjes, për me u futur në rekomandimet e tyre. I njëjti auditor ka qenë në vitin e kaluar edhe këtë vit, janë dy gjera që duhet me i kuptuar, se ne kemi qenë të shkelur vitin e kaluar nga i njëjti auditor, me çka edhe veprimet e mija nuk kanë qenë aq etike me krahasuar me detyrën e kryetarit, sepse nuk kam pranuar me u takua për tre herë radhazi, për qëllimin se, ndëshkimi ka qenë i paarsyeshëm. Këtë e vërteton më së miri konsulentja që e kemi pasur në komunën e Kaçanikut, për ndëshkimet që na i kanë bërë për kontingjentet. Konsulentin që e kemi pasur dy vite radhë, nuk është pajtuar me vendim të opinionin, por të njëjtën kohë kemi pasur edhe Besnik Osmanin- drejtor gjeneral i auditimit në Kosovë për disa vite, i cili të njëjtën gjë e ka shprehur. Unë jam i bindur që kryesuesi i auditimit e ka pa që komuna e Kaçanikut padrejtësisht është ndëshkuar në vitin e kaluar. Jo që nuk ka pasur të gjetura, por ata të gjetura nuk kanë qenë, që me ndëshkuar komunën dhe mos me qenë pjesë e garës. Ne jemi pajtuar me një opinion ndëshkues, se nuk kemi pasur mënyra tjera, përkundër se i kemi ngritur shqetësimet dhe kërkesat. Opinioni i këtij viti është më i miri deri me tani, për kundër të gjeturave dhe do të mundohemi për me pasur kësi raporti.

z. Bahri Selimi: Fillimisht kam një notë proteste, se është hera e parë nga viti që jam drejtor nga 2014, injorohem. Unë e ndiej vetën përgjegjës me dhënë sqarime profesionale, se u kalua KAB pa e ditur sa është buxheti. Përkundër sqarimeve që u dhanë, mungoj ana profesionale. Nuk me është dhënë fjala, ky rend nuk ka qenë kështu me herët. E shoh që ka probleme, por u dhanë përgjigje nga të tjerët. U potencua se auditori në vitin e kaluar ka qenë i njëanshëm, ne e kemi dhënë përgjigje se nuk kemi qenë të kënaqur me opinionin e auditorit të detyrimet kontingjente. Sivjet është tjetër vlerësim i auditorit, ishte vlerësimi i juaj të kryesuesi i auditimit të jashtëm, ata me rregullore Zyra kombëtare e auditimit e ka të përcaktuar që mundet tre herë rend me qenë i njëjti kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit drejtor, e para pikë, unë e mbajë rendin në seancë, ndërkaq asnjëherë nuk jeni të anashkaluar, ndoshta e keni marrë ju ashtu, pa vetëdije ke mundur me u anashkaluar, unë as që e kam vërejtur se po anashkaloheni në këtë drejtim. Nuk pati asnjë pyetje konkrete në raport me KAB, me tepër u fokusua për një shkollë që u dashtë, sidoqoftë ke mundur me kërkuar fjalën qysh e kërkoje tani. Unë, as që tentoj me mbuluar fushën e juaj, ndërkaq të drejtën e diskutimit e kam, edhe pse shpesh herë po me akuzojnë se po përgjigjem për drejtorët. Unë diskutoj se e kam të drejtën me diskutuar e jo me mbuluar asnjë fushë, ju jeni me mbuluar fushën e juaj dhe asnjëherë nuk duhesh me mu drejtuar kështu. Në diskutimin që e thashë paraprakisht, jo vetëm unë, por të gjithë tjerët, u tha se është bërë një punë e mirë, meqë është një raport i auditorit i vlerësuar mirë. Aty barra kryesore është e DBF, emrin nuk të përmenda, por ajo nënkuptohet se auditimi bëhet për pasqyrat vjetore financiare.

z. Bahri Selimi: U kalua KAB, pa e ditur sa është buxheti. Unë e kam kërkuar fjalën, mundeni me shikuar incizimin e mbledhjes. Unë e ndiej obligim ndaj KK me dhënë sqarime të nevojshme dhe jam i thirrur me dhënë sqarime profesionale për anën financiare.

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin lidhur me buxhetin e kanë anëtarët e KK. Ne kemi pasur me diskutuar orientimet që i ka paraparë ekzekutivi për shpërndarjen buxhetore. Kësaj çështje nuk është mirë me i dhënë kahe tjetër, të betohem se asnjë interesim me të anashkaluar nuk ka qenë. Nëse e keni kërkuar fjalën e nuk të kam vërejtur, të kërkoj falje se nuk kam pasur kurrfarë qëllimi. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatohet se Kuvendi i Komunës,

Njoftohet

Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2022/ Lënda: 01Nr. 104/02-14135/23.

Pas kësaj pike, me kërkesën e anëtarëve të KK, u lejuan 10 minuta pauzë. Pas pauzës, vazhdoj mbledhja me pika e mbetura:

5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit, nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Fillimisht shfrytëzoj rastin t'i kërkoj falje drejtorit të financave nëse e ka marrë të qëllimshme mos marrjen e fjalës të KAB, e qëllimshme nuk ka qenë, të tjerat mbesin ashtu siç i thashë. Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: E ndjeva për obligim me u kthyer ne seancë ndaj kryetarit të komunës dhe ndaj anëtarëve të KK. E ngrita shqetësimin, se u fol se nuk ka investime në bujqësi, dhe mbeti pa sqaruar çështja. Nga të gjeturat në Raporti i auditimit të vitit 2022, raporti është i pamodifikuar pa theksim të çështjes, ekzekutivi i komunës e ka përgatitur planin e veprimit zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit, nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2022. Materialin e keni, nëse keni pyetje, do të përgjigjem në vijim.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është një informatë që e sjellë drejtori me njoftuar KK sesi mendon me iu qasur zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Me vet fakti që na është sjellë në KK ky plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, të bënë me kuptuar se plani i veprimit nuk ka shkuar ashtu siç është përcaktuar në aspektin e ligjshmërisë, andaj kanë dalë rekomandimet. Kjo është në përgjegjësi të ekzekutivit të komunës, përkatësisht e kryetarit të komunës për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Mirë që është bërë një plan veprimi, mirëpo për mua është e pakuptimtë si të zbatohen këto rekomandime të vitit 2022, kur në disa projekte është vepruar njëjtë edhe në vitin 2023. I mora disa shembull edhe me herët, por si shembull po e citoj: Projektin e rrugëve urbane dhe rurale, ku përkundër rekomandimeve të dhëna në raportin e auditorit të v.2022, është vepruar njëjtë edhe në vitin 2023. Projektet janë futur një kod buxhetor dhe nuk ka projekte vetëm paramasa.

z. Adnan Reka: Unë dua t'ju jap një pasqyrë të zbatimit të rekomandimeve të auditorit ndër-vite, që ta shohim progresin e komunës tonë. Për vitin 2015, nga 13 rekomandime të Auditorit, vetëm 2 janë zbatuar. Për vitin 2016, nga 24 rekomandime të Auditorit, vetëm 9 janë zbatuar. Për vitin 2017, nga 13 rekomandime të Auditorit, vetëm 5 janë zbatuar. Për vitin 2018, nga 11 rekomandime të Auditorit, vetëm 4 janë zbatuar, Për vitin 2019, nga 10 rekomandime të Auditorit, vetëm 5 janë zbatuar. Për vitin 2020, nga 6 rekomandime të Auditorit, vetëm 3 janë zbatuar. Ndërsa, për vitin 2021, nga 7 rekomandime të Auditorit, janë zbatuar 5, 2 rekomandime prapë kanë mbetur të pazbatuara. Por, me auditor si ky i fundit (Florim Beqiri) edhe mund të ketë ndonjë progres.

z. Bahri Selimi: Zbatimi i rekomandimeve Adnan 100% nuk është bërë asnjëherë. Të gjeturat janë të pranuar se kanë ndodhur, jemi pajtuar për zbatimin e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatohet se Kuvendi i Komunës,
Njoftohet

Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit, nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2022 / Lënda: 01Nr. 104/02-14581/23.

6. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën ia kalojmë fillimisht drejtorit për sqarime, pastaj e hapim diskutimin:

z. Bahri Selimi: Në seancën e kaluar është votuar gati i njëjti vendim, iu falënderoj, mirëpo nuk ka qenë vendimi për krejt rezervat komunale. Në atë mbledhje iu kemi njoftuar se të DSHMS shuma prej 50,000€ nuk ka qenë e përfshirë në atë vendim. Ministria nuk na i kalon si vendim të pjesshëm. Ky propozim vendim e përmbledhë shumën 120,000€ sipas tabelave të buxhetit për vitin 2023, duke u specifikuar se në cilat projekte shkojnë këto mjete nga rezerva dhe ua kemi dërguar edhe një herë për votim. Edhe një herë iu falënderoj për herën e kaluar dhe kërkoj falje që e kemi dërguar edhe një herë për miratim, çështjen e mjeteve nga rezerva komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Fillimisht është dashur të shfuqizohet vendimi i mbledhjes se kaluar që e kemi marrë, pastaj të vjen propozim vendimi i ri në KK. Ndryshimi që bëhet në vendim, është vetëm pika 1.3. të programi buxhetor i shërbimeve të shëndetësisë primare 74700 me kod funksional 721 nga rezerva komunale me fond burimor në shumë prej 50,000€. E njëjta transferohet në kod të njëjtë, vetëm janë ndryshuar shpenzimet kapitale. Transferi që po i bëni, janë të shëndetësia, në një kod të njëjtë. Është konfuze që mjetet buxhetore nga rezerva e shëndetësisë nga i njëjti kod buxhetor të bartën të njëjtin kod. Këto mjete i keni pasur në rezervë në vitin e kaluar, dhe e keni blerë veturën nga një kategori tjetër e mjeteve dhe nuk keni mundur me i shpenzuar këto mjete. Tani po i bartni dhe qysh mundeni me na bindur neve se i shpenzoni për të njëjtin qëllim, se ju i keni pasur në dispozicion mjetet dhe nuk keni ditur me i shfrytëzuar, se keni blerë auto veturë nga e njëjta kategori e mjeteve, në shumë mbi 24,000€, mjetet janë paguar nga kategoria tjetër, kjo është e pakuptimtë.

z. Bahri Selimi: Mjetet nga rezerva komunale transferohen nga shëndetësia, në një projekt të ri, 721 është kodi i DSHMS. Mjetet transferohen në projektin, blerja e automjetit-kombit për hemo- dializë, shuma 50,000€. DSHMS nuk e ka pasur të definuar mirë se a po e blenë këtë automjet, apo jo, ndërkohë në konsultim me drejtorin e QKMF, ka vendosur me blerë këtë automjet. Mjetet bartën në të njëjtin kod, por në kategori tjetër ekonomike. Kur mjetet janë në rezervë, nuk mundemi me i shpenzuar. Rezerva është kategori e veçantë e buxhetit. Rezerva nuk është kategori e rregullt siç janë kategoritë tjera. Kur ne e kemi aprovuar buxhetin, ndërkaq nuk ia kemi lënë emrin e saktë një projektit, ministria gjatë shqyrtimit na i ka kthyer mjetet në rezervë- i lënë si pezull këto mjete, se na thonë se nuk i keni specifikuar mirë këto mjete. Nuk është patjetër me i lënë për IK, mundesh për subvencione dhe transfere, mallra dhe shërbime, mirëpo është vendosur nga drejtoria me shkuar në IK.

z. Agim Mani: Unë e kam të paqartë drejtor, kodi funksional 721 transferohet në kod 721, vetëm emërtimin e keni ndryshuar. Nëse këto mjete mbetin në kodin 721, a mbetin në rezervë?

z. Bahri Selimi: Jo nuk mbetin në rezervë, kodi 721 është shëndetësia, këto mjete kanë ardhur nga granti specifik. Mjetet nga granti specifik nuk mundem me i transferuar as në arsim as në

administratë komunale. Të shëndetësia dhe arsimi veç mundesh me mbushur mjete prej drejtorive tjera, a me hequr mjete nuk guxojmë. Në shëndetësi është rezerva, në shëndetësi mbetet, por jo më në kategorinë e rezervës, por në IK, kodi rezervë shuhet dhe kalon në IK.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimin e mbledhjes se kaluar duhet me shfuqizuar, mos t'na bëhen dy vendime. Atëherë me shtimin e një pike për shfuqizim të vendimit të mbledhjes së kaluar e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 17 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 2. Prezentë 24. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2023/ Lënda: 01Nr. 400/01-14258/23.

7. Propozim Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, në Zonat Kadastrale: Doganaj, Koxhaj, Begracë, Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ernesta Krasniqi: Të Propozim Vendimi Paraprak, ashtu si edhe herëve tjera që e kemi potencuar që procedurat paraprake për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale kanë shkelje ligjore dhe për çdo procedurë paraprake që ka shkelje ligjore, mendimi jonë është kundër, është për këtë vendim jemi kundër.

Kryesuesi i Kuvendit: A mundesh konkretisht me specifikuar, se këtu po ia japim të drejtën komisionit vlerësues me vepruar, ky ende nuk është vendim dhe na tregoni se ku ka shkelje ligjore.

znj. Ernesta Krasniqi: Në momentin që pronat dalin vitin 2023 që janë të mundura me u dhënë në shfrytëzim në, ligji e cakton qartë me u caktuar për sa kohë me u dhënë në shfrytëzim dhe për çfarë biznesi do të epën. Ne vazhdimisht kemi kërkuar me na ardhur për sa kohë ka me u dhënë dhe për çfarë lloji biznesi. Për kundër kërkesave tona, propozim vendimi na ka ardhur me u dhënë në shfrytëzim, afatgjatë dha afatshkurtër, për këtë arsye qëndrimi ynë është kundër.

Kryesuesi i Kuvendit: Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale e përcakton dy afate kohore me u dhënë pronat komunale në shfrytëzim, afatgjatë 15-99 vjet dhe në afatshkurtër 1-15vjet. Kuvendi sipas LVL ka të drejtë të themeloj mekanizma për me lehtësuar punën e KK dhe ia rekomandoj çështjet KK për të cilat kuvendi duhet me vendosë. Këto prona në bazë të listës së miratuar në fund të viti të kaluar. KK merr një vendim paraprak për dhënien e atyre pronave në shfrytëzim dhe formon komisionin vlerësues për dhënien e tyre në shfrytëzim.

z. Agim Mani: Kam një pyetje, pse nuk e keni sjellë komplet listën e pronave?

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtoria e ka një bazë se cilat prona epën në shfrytëzim, prona është shumë e gjatë, lista është shumë e gjatë dhe me nisur një procedurë të atyre pronave është një punë shumë e madhe dhe më tepër së për gjysmën e tyre mundet mos me pasur interesim. Drejtoria e urbanizmit, kërkesat për me dhënë pronat në shfrytëzim e bënë në bazë të letrave shprehjes së interesit që i bëjnë kompanitë e ndryshme. Komisioni që formohet është për një vendim, jo për të gjitha pronat.

z. Adnan Reka: Rregullorja nr. 9/2020 e përcakton dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Në bazë të nenit 6 pika 2, lista e pronave të paluajtshme që epën në shfrytëzim duhet të përmbaj këto të dhëna: të dhënat kadastrale të pronës i ka pasur), qëllimin, destinimin (nuk e ka pasur), destinimin (nuk e ka pasur), datën e njoftimit të publikimit dhe periudhën kohore të dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës (nuk e ka

pasur). Kur të propozohet lista e pronave duhet t'i përmbajë këto prona, jo pastaj. Sa e kuptova Ernestën tha se, procedurat paraprake janë shkelur.

Kryesuesi i Kuvendit: Neve atë procedurën paraprake që po thoni ju, vendimin e kemi marrë në KK. Ju po supozoni që e kemi shkelur procedurën ligjore, por ne e kemi vlerësimin e ligjshmërisë për atë vendim nga Zyra ligjore që është kompetent për shqyrtimin e ligjshmërisë, ata janë kompetent me vlerësuar se a e kemi shkelur ligjin apo jo, dhe sipas tyre vendimi i KK është në rregull. Për procedurat tjera, është një komision që ka me u formuar që ka me i zhvilluar procedurat për këto prona.

z. Qamil Stagova: Në bazë të propozim vendimit, 9 prona do të epën në shfrytëzim, 8 prej tyre në afat të gjatë kohor, 1-99 vjet dhe 1 në afatshkurtër, 1-15 vjet. Ne kemi marrë vendime edhe me herët për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, ka pasur edhe prona të veçanta, është zhvilluar kjo procedurë dhe MAPL i ka vlerësuar të ligjshme apo ministria e linjës. Mund të ketë pasur ndonjë vërejtje të cilat janë sqaruar, por nuk kanë qenë të kundërligjshme.

z. Rustem Zenuni: A e keni fjalën për këtë listën e veçantë apo për listën e përgjithshme të pronave komunale? Ne kur kemi marrë vendime për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, ju vazhdimisht jeni shprehur, duke thënë se qeveria funksionon. Tani po me habitë fakti që nuk po i besoni qeverisë për vlerësimet të cilat i ka dhënë për pronat komunale. Nga ai dështim, kur kthehen vendime të kundërligjshme, i pranoni, ndërkaq kur janë të ligjshme, jo.

z. Adnan Reka: Nuk është hera e parë që ne në këtë KK kemi marrë vendime të kundërligjshme, për kundër ministrive të linjës. E kemi objektin e ETC që me PZHK ka qenë një ndërtesë rekreative sportive. Ministrinë e linjës na kanë thënë se, jemi duke shkelur PZHK, por ne këtu në këtë kuvend kemi thënë se, kur është në pyetje një çështje që është në interes të qytetarëve, ne do të shkelim edhe ligjin. Ligjin e kemi shkel dhe sot e kemi ETC, dm.th. kemi raste kur është shkelë ligji, se ka këtu anëtarë të KK që kanë qenë në atë legjislaturë.

Kryesuesi i Kuvendit: Për atë rast që e potencove, unë kam qenë anëtar i KK, ne e dimë se shqyrtimi i ligjshmërisë është 15 ditë. Ne afatin e përcaktuar ligjor, nuk ka pasur përgjigje, kështu që në respektim të afatit ligjor, është publikuar vendimi i KK, në bazë të procedurës. Më vonë se çka ka ndodhur, unë nuk e di, por çështja është se nuk kanë kthyer përgjigje në afatin e përcaktuar ligjor, në të kundërtën kishim shkuar në procedurën gjyqësore. Vendimet të cilat i shqyrton ministria e linjës në afatin e përcaktuar ligjor dhe kërkon me i rishqyrtuar, nëse nuk i rishqyrtojmë, përmes ministrisë së drejtësisë i dërgon në gjykatë. Për këtë rast, sa unë jam i informuar, nuk ka ndonjë lëndë në gjykatë.

z. Adnan Reka: Përveç atij rasti, në këtë legjislaturë, ne nuk e kemi rishqyrtuar vendimin e ministrisë së linjës, për kundër vendimit të gabuar që kemi marrë në KK, përkundër faktit që kanë kërkuar, sepse vendimi ka qenë i padrejtë. Është fjala për disa prona në Bob, janë incizimet, mundemi me i kthyer, ju vet keni thënë se unë shkoj në përgjegjësi për këtë punë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne i kemi tani 2 vendime që na i ka kthyer ministria, është në përgjegjësinë time me sjell në KK me e trajtuar çështjet në KK qysh i kërkon ministria, ndërsa se qysh vendosë KK ajo është çështje tjetër. Zbatimi i vendimit pastaj kalon të ai që ka me zbatuar, e që ministria ka thënë se, nuk është në rregull vendimi. Ne në KK e kemi trajtuar, ndërkaq në shumë raste drejtoritë komunikojnë me ministrinë për informata shtesë dhe i tejkalojnë ato çështje. Sidoqoftë, obligimi ynë ligjor është që kërkesat që na vinë nga ministria, me i trajtuar me kohë në KK, ndërsa qysh merret vendimi ajo është çështje tjetër. Janë raporte 6 mujore dhe vjetore të MAPL dhe në ato raporte nuk ka shkelje të theksuara të komunës së Kaçanikut.

z. Betim Shala: Sipas ligjit për dhënien e tokave në shfrytëzim, për me u dhënë tokat në shfrytëzim, duhet të jenë në përputhshmëri hapësinore dhe me PZHK. Ne si grup parlamentar i LDK nuk e përkrahim këtë vendim. Neve në vitin e kaluar na ka mbetur një vendim pa u përfunduar i cili vendim i ka kaluar të gjitha fazat, si atë të vlerësimit të komisionit, në KK është kërkuar me u ndryshuar diçka lidhur me atë pronë, por i njëjti nuk ka ardhur më në KK për me u marrë vendimi përfundimtar.

z. Rrustem Zenuni: Raporti i MAPL për funksionimin e komunave a është në faqen zyrtare të MAPL.

Kryesuesi i Kuvendit: Po, Raporti i MAPL për funksionimin e komunave gjendet në faqen e MAPL.

z. Agim Çaka: Kur e kemi votuar listën e pronave komunale për me i dhënë në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, unë kam votuar për këtë listë, që ne me iu treguar qytetarëve se këto prona janë në dispozicion me u dhënë në shfrytëzim, d.m.th. nuk është marrë vendim me i dhënë, por si listë e aprovuar u publiku, për të cilat qytetarët e komunës mundën me i interesuar për me i marrë në shfrytëzim. Në seancat e kaluara, kemi kërkuar një raport për pronat të cilat janë dhënë në shfrytëzim deri me tani, dhe kjo tregon seriozitetin se a jemi duke punuar si duhet. Kjo nuk është punë e rëndë me u hartuar, me ditur sa prona i kemi dhënë, investitorët, ku kanë mbërri me investime, a janë serioz, se ka investitorë që nuk janë serioz. Ligji për dhënien e pronave në shfrytëzim e specifikon qartë që secila pronë që epët në shfrytëzim, ka me ardhur në KK, dhe për secilën pronë formohet një komision i veçantë dhe unë edhe pse kam votuar për marrë vendim për secilën në veti, duke marrë parasysh specifikat, terrenin, mendimin e qytetarëve, se a bënë apo nuk bënë. Kërkesa ime kryetar është me sjellë një raport për pronat e dhëna në shfrytëzim, se kemi edhe përgjegjësi se nesër mund t'na akuzojnë, se është papërgjegjësi e madhe me dhënë pronë dikujt dhe mos me bërë asgjë investitori në atë drejtim, se është edhe në përgjegjësi tona marrja e këtyre vendimeve.

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti në KK për pronat që janë dhënë në shfrytëzim, duhet të vjen në KK. Kryetari sa e di unë e ka formuar një komision dhe e kanë hartuar një raport, kanë mbetur edhe disa përgjigje të operatorëve me i sqaruar. Raporti ka me u sjellë në KK se është edhe obligim ligjor për ecurinë e pronave. Neve na ka përcjellë një periudhë jo e përshtatshme ekonomike, një herë pandemia, lufta në Ukrainë rezultojë me inflacionin, sidoqoftë ata e kanë pasur arsye, tani nuk kanë. E dimë se ka prej tyre që kanë investuar dhe atyre që nuk kanë investuar, me në atë çështje, me këto çështje do të merret kryetari dhe do të raportoj në KK dhe kjo çështje ka me qenë publike. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 13 votë Për, Kundër ishin 10, Abstenuan 2 (Raif Kasa dhe Agim Çaka). Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori

VENDIM PARAPRAK

Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, në Zonat Kadastrale: Doganaj, Koxhaj, Begracë, Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 104/02-13790/23.

8. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, komisioni vlerësues që do të punoj në udhëheqjen e procedurave të dhënies së pronave komunale në shfrytëzim, përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 nga KK, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga OJQ. Unë e ngriti si shqetësim çështjen e pagesës së komisionit, sepse me ligjin e ri, komisionet nuk paguhen, ndërkaq disa komuna po e praktikojnë çështjen e kompensimit në një pikë të vendimit, me caktuar shumën dhe numrin e mbledhjeve që do të paguhen. E hapi diskutimin: Nëse nuk ka kush me diskutuar, shkojmë me propozime:

z. Qamil Stagova: Nga ekzekutivi i komunës do të jenë: Besmir Krasniqi dhe Arbnora Kuka.

z. Rustem Zenuni: Nga PDK e propozojmë Bashkim Krasniqin.

z. Agim Mani: Nga LVV e propozojmë Bashkim Lumën.

Kryesuesi i Kuvendit: Nga OJQ, Remzi Reka.

z. Betim Shala: Në Komitetin për Komunitete është anëtar nga OJQ Arben Thaqi, ndërkaq nuk është paguar, edhe pse ligji ia lejon pagesën. Kërkoj me iu bërë kompensimet Arben Thaqit.

z. Rustem Zenuni: Për çështjen e kompensimit, ne propozojmë të shtohet një nen me shumën e përcaktuar 50 € dhe mos të paguhet me tepër se 6 mbledhje.

z. Agim Mani: Komisioni vlerësues ka shumë punë dhe mban mbi 6 mbledhje.

z. Naim Beça: Pyet për anëtarët e komisionit nga ekzekutivi i komunës dhe nga OJQ.

Kryesuesi i Kuvendit: Besmir Krasniqi është zyrtar në kadastër, Arbnora Kuka është zyrtare në drejtorinë e Shëndetësisë, Remzi Reka është nga OJQ- Gjethi. Atëherë propozimet që dolën së bashku me pagesë, i shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 23 votë Për, Kundër nuk ka, Abstenuan2 : Raif Kasa dhe Naim Beça. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

VENDIM

Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej 5 anëtarëve:

- | | | |
|---------------------|--------|--------------------|
| 1. Besmir Krasniqi | anëtar | (Ekzekutivi); |
| 2. Arbnora Kuka | “ | (Ekzekutivi); |
| 3. Bashkim Krasniqi | “ | (Kuvendi- PDK); |
| 4. Bashkim Luma | “ | (Kuvendi-LVV); |
| 5. Remzi Reka | “ | (Shoqëria Civile). |

Për punën e vet, komisioni i përcaktuar, do të paguhet nga 50 € për një takim, por jo me tepër se për 6 takime/ Lënda: 01Nr. 104/02-13788/23

9. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara, shkollave të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: DBPZHR siç e dini në çdo vit e sjell në KK masën drusore të konfiskuar, dhe masa drusore çdo herë iu ka dhënë shkollave, sikur edhe këtë herë që është propozuar. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Mirë është që po iu ndahen shkollave masa drusore e konfiskuar, se shkolla është institucion, ndërkaq në KPF kam thënë me ia dhënë SHIL, mirëpo ishte një rregullore që ndarja me SHIL bëhet 50%, por tani është çështja se kemi 2 variante të masës drusore, 39 m dhe 57m. Duhet të dimë se cili është varianti i saktë, kjo duhet të rregullohet.

z. Suhad Dullovi: Masa drusore e konfiskuar është 39.9m³, ndërsa me metër hapësirë i vjen 57.05. Sasinë e druve të konfiskuara, 50% i ndahen shkollave, ndërkaq 50% SHIL, që i bien diku nga 28.50.

z. Agim Mani: Metra në hapësirë është metër në gjatësi, e cila aplikohet të drutë në 3D, ku matet perimetri, baza shumëzuar për lartësinë. Unë jam inxhinier dhe unë di këto çështje dhe mundem me i bërë këto tolerime.

z. Suhad Dullovi: Metra kub nuk është metër në katror. Çka nëse është trup ?

z. Agim Mani: Nëse është trup, i bien metër hapësirë.

z. Suhad Dullovi: Sqaroj se sipas ligjit në fuqi që e rregullon këtë çështje, masa drusore e konfiskuar është e hyrë e komunës -aset i komunës dhe komuna ka të drejtë me ua ndarë shkollave.

z. Agim Çaka: Ne drejtor po e dimë se drutë janë aset i komunës, por sa është saktësisht sasia e druve të konfiskuara?

z. Suhad Dullovi: Gjithsej janë 57.05mh dru të konfiskuara.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë të përcaktuara shumat e metër kub dhe metër hapësirë, dikush e merr përgjegjësinë që i ka shkruar këto shifra. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 18 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 7. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndarjen e masës drusore të konfiskuara, shkollave të komunës / Lënda: 01 Nr. 08-322/14537/23.

10. Raporti i KRM “ Pastërtia” SH.A- Njësia Kaçanik, lidhur me menaxhimin e Parkingjeve publike në komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Raporti na ka ardhur i përgjysmuar. Në bazë të këtij raporti, nëse parkingu funksionon me kapacitet, del fitimi me i ulët, 3,400€ me 9 punëtorë. Me një vendim që kemi marrë në KK, i kemi shkaktuar humbje komunës të parkingjet shumë 25,000€, sepse pa të drejtë i janë dhënë kompanisë “ Pastërtia”. E paqartë është kur është bërë kalkulimi të punëtorët për vitin 2022, kanë qenë vetëm 3 punëtorë, ndërkaq kontrollor 2. Nëse merret për bazë ky raport, në total kompania ka dalë me minus.

z. Naim Beça: Raport me të keq se ky raport nuk kam pa. Në raport ka shumë kundërthënie, ashtu që në një muaj, muajin maj është dalë kompania me fitim 4,000€, ndërkaq në një muaj tjetër del me humbje për 4,000€. Kjo të bënë me kuptua për menaxhim të dobët të parkingjeve nga kompania. Janë përmendur 2 punëtorë të mirëmbajtjes dhe hapësirave publike, ata punëtorë paguhen nga komuna. A janë ata punëtorë aty permanent, sepse në raport janë përfshirë edhe pagesat për këta 2 punëtorë, e që nuk është dashur të përfshihen. Kompania është dashur me dalë me një deklaratë që për një muaj ka dal me 4,000€ fitim dhe për një muaj tjetër me 4,000€ humbje. Qysh është e mundur kompania me i pasur 2 punëtorë dhe 2 kontrollorë, kjo flet për menaxhim të dobët të saj. Unë edhe në mbledhjen e kaluar kam thënë se, kjo çështje është e planifikuar dhe parkingjet ka me i marrë dikush në menaxhim.

Kryesuesi i Kuvendit: Kur e kemi marrë vendimin për me ia dhënë kompanisë parkingjet publike, Agimi e kalkuloj vetëm çështjen e menaxhimit të parkingjeve, ndërkaq kompania e ka pasur obligim me i mirëmbajtur edhe hapësirat publike. Mjetet që i kanë përfituar dhe ato që i kanë dhënë për mirëmbajtje të hapësirave publike, ka dalë me humbje dhe janë detyruar me hequr dorë nga menaxhimi i tyre. Shpjegim me të hollësishëm na jep drejtori i DSHPE.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kontrollorët e terrenit, a kanë pas përgjegjësi me i menaxhuar punëtorët e parkingut dhe ata të mirëmbajtës së hapësirave publike dhe kujt i kanë raportuar ?

z. Ramadush Osmani: Fillimisht iu falënderoj për shfuqizimin e vendimit për menaxhimin e parkingjeve publike nga “Pastërtia”. Kjo me ka mundur të procedoj edhe shpalljen publike dhe të kontrakttoj menaxhimin e parkingjeve dhe hapësirave publike. Raporti është 1 vjeçar, këtu po ndërliken shumë çështje, punëtorët e mirëmbajtjes janë punëtorë të kompanisë, nuk i paguan komuna. Ata edhe kur kanë qenë parkingjet me operatorë privat, kemi pasur marrëveshje që komuna me ua proceduar një shumë të caktuar për mirëmbaje, punëtorët janë të kompanisë. Menaxhimi i kompanisë me 2 kontrollorë, është çështje e kompanisë. Unë iu kam thënë atëherë kur kemi pas marrëveshje, merri parkingjet, fito prej tyre dhe mirëmbani

hapësirat publike me vlerën e përcaktuar. A është raport i mirë apo i keq, ai që e ka hartuar i qëndron prapa. Janë shifrat me sa punëtorë ka operuar, sipas muajve dhe të hyrat. Nëse e merr një muaj të vitit 2022 me 3 punëtorë dhe një muaj të vitit 2023 me 9 punëtorë, dallon se ka të hyra tjera. Mua me është dukur raport i mirë, janë precizuar të gjitha detajet nga periudha e menaxhimit. Ne, nga muaji korrik kemi me lidhë kontratë me një operatorë, i cili do të menaxhon parkingjet, me të hyrat do t'i mirëmbajë hapësirat publike.

z. Bashkim Luma: Besoj që drejtori nuk është dashur me shfuqizuar marrëveshjen me kompaninë “Pastërtia”. Fillimisht është dashur të kërkoj që kontrollorët e terrenit mos të jenë punëtorë të kësaj marrëveshje, sepse kur i analizojmë shpenzimet që i kanë bërë kontrollorët, dalin shumë me shumë sesa humbja që është realizuar. Nëse i largon kontrollorët, del se KRM “Pastërtia” ka dal në fitim. Fillimisht është dashur si politikë ti dërgohet kompania me i larguar kontrollorët, se nuk kanë pasur ndonjë përgjegjësi të madhe sa me marrë gjithë këtë shumë të pagës, pastaj nëse nuk vjen deri të fitimi, por ka humbje, atëherë isha pajtuar me u shfuqizuar vendimi.

z. Naim Beça: Drejtor, ndoshta juve ju duket raporti i mirë, ndërsa mua me duket e palogjikshme. Nëse i referohemi menaxhimit të parkingjeve janar-maj 2023, në shkurt 8 punëtorë, kontrollorë të terrenit 2, punëtorë të mirëmbajtjes së hapësirave publike 2. Shuma e humbjes 703€. Në mars, 9 punëtorë, fitimi 1645€. Në muajin tjerë, 6 punëtorë, 1265€ minus, qysh është e mundur kjo. E dyta, në periudhën janar-dhjetor 2022, në gusht 168€, 498€ minus në shtator, tetor 1020€ minus me numër të njëjtë të punëtorëve. Si mundet me qenë të hyrat për parkingje në muajin mars 7,000€, ndërkaq 3,000€ në korrik dhe gusht kur ka bashkatdhetarë, për mendimin tim, ky raport nuk është logjik.

Kryesuesi i Kuvendit: Raportin e ka hartuar kompania, drejtori e ka sjellë këtu, dhe ne në bazë të këtij raporti, po e shohim menaxhimin e parkingjeve nga kompania, e cila ndoshta për shkak të jo menaxhimit të mirë, ka ardhur deri të humbja dhe nuk mundet me menaxhuar më, kështu që e shfuqizuan atë vendim dhe drejtori me i udhëhequr proceduat me dhënë në shfrytëzim parkingjet publike. Ne, nëse vërejmë parregullsi, është komisioni i aksionarëve, i cili e ka për obligim me iu përgjigjur KK për parregullsi të tilla. Mund të kërkojmë llogari nga “Pastërtia” se edhe aty jemi aksionar dhe raporte tjera në vazhdimësi përmes komisionit të aksionarëve, për me pa si funksionon kompania. Drejtori na jep sqarime: Pse nuk është askush këtu nga KRM “Pastërtia”?

z. Naim Beça: Ata të kompanisë është dashur me qenë këtu, se kanë përgjegjësi, se paguhen me taksat e qytetarëve. Drejtori po thotë se, raport i mirë, ndërkaq ata duhet me qenë këtu, se kanë përgjegjësi ndaj qytetarëve, dhe me i sqaruar gjërat, se qytetarët mendojnë se ata të kompanisë i kanë mbledhur paratë.

z. Ramadush Osmani: Nuk e keni lexuar raportin mirë. Muajin mars 7,000€, 1200€ janë inkasuar në këtë muaj nga dhënia me qira të palestra për lojërat. Për atë ka dalë në fitim, se nuk është në rregull me dalë me reagu publikisht me ato që po thoni.

z. Naim Beça: Raportin e kam lexuar, janë 7,274.30€.

z. Agim Çaka: Këto shifra në raport, tregojnë se kompania ka menaxhuar me humbje, dhe kjo është një bazë për me ia marrë menaxhimin.

z. Rustem Zenuni: E kemi raportin, por duhet kërkuar llogari prej juve, se nuk keni arritur me kërkuar llogari nga bordi.

z. Bashkim Luma: Unë si komisionar i atij komisioni i KRM “Pastërtia”, si grup i LVV, kemi qenë kundër këtij vendimi. Andaj është e padrejtë të thuhet se, komisioni nuk ka vepruar në

këtë rast. Ne kemi qenë kundër, sepse kompania ‘Pastërtia’ nuk është për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

z. Adnan Reka: Është e padrejtë me iu drejtuar Bashkimit, kur kryesues i komisionit të aksionarëve është drejtori i DSHME. Drejtori edhe si drejtor edhe si kryesues i komisionit, duhet me i ngritur shqetësimet si menaxher, ndërkaj nuk po e anashkaloj as Bashkimin si anëtar i komisionit, ndërkaj nuk mundeni me ia hequr përgjegjësinë drejtorit e me ia adresuar Bashkimit.

z. Rustem Zenuni: Unë po kërkoj nga anëtarët e KK e jo nga anëtarët e ekzekutivit.

z. Adnan Reka: Unë thashë, kryesues i komisionit të aksionarëve është drejtori. Në momentin që je kryesues i komisionit, keni edhe përgjegjësi.

Kryesuesi i Kuvendit: Komisioni i aksionarëve është themeluar në KK dhe i raporton KK, përgjegjësia është e njëjtë për të gjithë anëtarët. Në momentin Bashkim që keni pranuar me qenë anëtar i komisionit, keni përgjegjësi për atë punë, sepse vendimi është marrë në KK me shumicë votash, keni pranuar me qenë anëtar i komisionit, pavarësisht qysh keni votuar dhe keni përgjegjësi me dhënë kontributin dhe me kërkuar përgjegjësi si komision i aksionarëve nga kompania, se mundesh me kërkuar edhe këtu, por përgjegjës me kërkuar jeni më tepër atje.

z. Bashkim Luma: Sa për informacion, kryetar i komisionit është drejtori. Ne si LVV kemi qenë kundër marrjes së vendimit, dhe po del se kemi pasur të drejtë. Vendimi që e ka marrë drejtori, e ka marrë pa u konsultuar me anëtarët tjerë të komisionit. Ju e keni shumicën dhe vendimet kalojnë, ndërkaj çështja është se, po vërtetohet se kemi pasur të drejtë. Keni marrë vendim jo të duhur, pa marrë hapa konkret në ndryshimin e menaxhimit të parkingjeve nga KRM “Pastërtia”.

z. Adnan Reka: Bashkimi po e qartëson plotësisht pozicionin e vet, veprimet e tija që i ka bërë në komision. Me rastin e sqarimit, e hoqi përgjegjësinë prej vetes. Komisioni ka përgjegjësi, por kryesuesi i komisionit e ka përgjegjësinë me të madhe, me i thirrë anëtarët e komisionit, me u konsultuar për vendimin, por nëse nuk i ka thirrë, atëherë nuk kanë përgjegjësi anëtarët tjerë.

z. Ramadush Osmani: Komisioni komunal i aksionarëve të ndërmarrjes, nuk është vetëm për një çështje, por për tërë menaxhimin e bodit të ndërmarrjes, për të gjitha aktivitetet. Të gjykohet një veprim i ndërmarrjes, me një qëllim të mirë, pa e analizuar performancën e ndërmarrjes, nuk është në rregull. Shumë mirë e ka potencuar si ka rrjedhur kjo punë, duke pa synimin e mirë të komunës, për me i krijuar një të hyrë shtesë kësaj kompanie, edhe duke marrë parasysh raportin e gjenerimit të hyrave të një kompanie private, që ia ka paguar këstin komunës dhe i ka mbajtur punëtorët dhe me ato mjete, ne kemi me i mbajtur hapësirat publike. Kjo e lejon komisionin e aksionarëve me ia dhënë mundësinë ndërmarrjes së vet me krijuar këtë të hyrë, mbi këtë bazë është nisur me qëllimin me të mirë. Tani çështja e menaxhimit të një aseti ka të bëjë me kompaninë sesi organizon me krijuar atë, ndërsa kësti që e ka pasur ndërmarrja private me ia dhënë komunës mjetet, kjo ndërmarrje ia ka dhënë me punë. Edhe menaxhmenti edhe bordi që e udhëheq një kompani, e analizon vetveten. Kompania e ka pa që nuk po ka llogari, me kohë ka kërkuar me ia marrë menaxhimin e parkingjeve nga komuna. E ka mbajtur një vit, ka tentuar me realizuar të hyra, nuk i ka dalë llogaria, e ka dorëzuar. Lehtë është me gjuajtur fajin, por duhet shikuar qëllimin, qëllimi ynë është mos me falimentuar kompania, se jemi aksionar me 13%, dhe ia kemi mundësuar me pasur një të hyrë ndërmarrja. Kam kërkuar me u votuar vendimi, e kam hapur shpalljen publike me 10.5€, me ato mjete kam mundësi me ri kontraktuar edhe mirëmbajtjen e hapësirave publike.

z. Bashkim Luma: Unë e kam princip me debatuar për temën, e jo me dalë jashtë saj. Meqë e kishim çështje debati parkingjet, unë tani nuk mund të foli për mbeturinat. Nuk është që nuk ka pasur ndërhyrje edhe në vendime tjera, në dorëheqjen e kryetarit të bordit në regjion të KRM “Pastërtia”, dhe nuk kemi marrë përgjigje për këtë çështje nga ekzekutivi apo kush është përgjegjës.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e di pse duhet me debatuar me kësi toni. Unë, nëse e ngriti tonin, nuk e kam të qëllimshme, por të natyrshme, pajtohem mos me dalë jashtë rendit të punës. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,

Njoftohet

Me Raportin e KRM “Pastërtia” SH.A- Njësia Kaçanik, lidhur me menaxhimin e Parkingjeve publike në komunën e Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 07-104/02-14451/23.

11. Kërkesa e MMPHI, për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 104/02-9142/23 i datës 28.04.2023 për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pjesës së PK Nr. 00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin Nerodime;

Kryesuesi i Kuvendit: Për këtë lëndë, ua kemi dërguar vlerësimin e ligjshmërisë, e shqyrtojmë se, a duhet shfuqizohet vendimi apo të mbetet në fuqi. Nëse është në harmoni me dokumentet që kërkohet nga ministria, mos të shfuqizohet. Para se me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Qamil Stagova.

